



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 70

6 maj

2013

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Akt normativ i KM nr. 2, datë 2.5.2013	Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme	3061
Akt normativ i KM nr. 3, datë 3.5.2013	Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit për Zhvillim Abu Dhabi, për financimin e projektit të bulevardit verior dhe të rehabilitimit të lumit të Tiranës	3062
Vendim i KM nr. 332, datë 18.4.2013	Për përcaktimin e kriterëve të tregtimit e të certifikimit të farave të perimeve.....	3071
Vendim i ERE nr. 40, datë 16.4.2013	Mbi një ndryshim në vendimin nr. 134, datë 17.9.2012, të marrëveshjes së furnizimit me energji elektrike midis shoqërisë KESH sh.a./FPSH dhe shoqërisë CEZ shpërndarje sh.a./FPP për periudhën 1.1.2012-31.12.2014, të ndryshuar	3093
	Vendim për shpalljen të vdekur të shtetasës Bakushe Visha	3093
	Vendim për shpalljen të vdekur të shtetasit Bejto Dedja	3093

AKT NORMATIV
Nr. 2, datë 2.5.2013

PËR RIVLERËSIMIN E PASURISË SË PALUAJTSHME

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Rivlerësimi i pasurisë së paluajtshme për individët

1. Të gjithë individët, të cilët kanë në pronësi pasuri të paluajtshme, kanë të drejtë që, nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri në datën 31 tetor 2013, të bëjnë rivlerësimin e kësaj pasurie me vlerën e tregut.

2. Ky rivlerësim mund të bëhet nga një ekspert i licencuar për vlerësimin e pasurisë së paluajtshme nga institucionet përkatëse ose nga zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

3. Në rast se individ i zgjedh që të bëjë rivlerësimin me një ekspert të licencuar, atëherë aplikimit të tij për rivlerësim të pasurisë së paluajtshme i bashkëlidh edhe aktin e vlerësimit të ekspertit.

4. Zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme llogarisin diferencën ndërmjet çmimit të kontratës së regjistruar në këtë zyrë dhe vlerës së pasqyruar në aktekspterin, si dhe tarifën që duhet të paguajë individ për ta regjistruar këtë rivlerësim.

5. Në rast se individ i zgjedh që rivlerësimi të kryhet nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme me çmimet minimale fiskale, atëherë ky fakt shprehet në aplikimin e tij për rivlerësim.

6. Në rastin e parashikuar në pikën 5 të këtij neni, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme llogarisin diferencën ndërmjet çmimit të kontratës së regjistruar në këtë zyrë dhe vlerës së dalë nga rivlerësimi me çmimet minimale fiskale, si dhe tarifën që duhet të paguajë shtetasi për të regjistruar këtë rivlerësim.

7. Tarifa, që paguhet për regjistrimin e këtij rivlerësimi, është 1% e diferencës ndërmjet vlerës së rivlerësimit me vlerën e kontratës së regjistruar në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

8. Në rastet kur pasuria e paluajtshme rezulton e regjistruar pa një kontratë shitjeje, atëherë, si vlerë regjistrimi, në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, konsiderohet vlera e çmimeve minimale fiskale në çastin e regjistrimit.

9. Aplikimi bëhet sipas formularëve standardë, të miratuar me udhëzim të Ministrit të Financave.

10. Për shitjen e pasurisë të bërë pas rivlerësimit, tatimi llogaritet si diferencë e çmimit të shitjes dhe çmimit të dalë nga rivlerësimi.

Neni 2

Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet deri në datën 31 tetor 2013.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

3061



AKT NORMATIV
Nr. 3, datë 3.5.2013

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS, NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT PËR ZHVILLIM ABU
DHABI, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË BULEVARDIT VERIOR DHE TË
REHABILITIMIT TË LUMIT TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit për Zhvillim Abu Dhabi, për financimin e projektit të bulevardit verior dhe të rehabilitimit të lumit të Tiranës.

Neni 2

Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE HUAJE

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT
PËR ZHVILLIM ABU DHABI PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË BULEVARDIT VERIOR
DHE REHABILITIMIT TË LUMIT TË TIRANËS**

Marrëveshje e datës _____ ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (më poshtë i quajtur “Huamarrësi” nga njëra anë, dhe Fondit për Zhvillim, Abu Dhabi (më poshtë i quajtur Fondi) nga ana tjetër:

duke marrë në konsideratë se Huamarrësi ka kërkuar nga Fondi të marrë pjesë në financimin e projektit të bulevardit verior dhe rehabilitimit të lumit të Tiranës, në favor të Përfituesit (Bashkia Tiranë), që përshkruhet më specifikisht në skedulin e dytë të kësaj Marrëveshjeje (më poshtë i quajtur Projekti);

dhe duke marrë në konsideratë se Fondi synon të asistojë vendet arabe, afrikane, aziatike dhe vende të tjera me ekonomi në zhvillim, duke u dhënë atyre huat e nevojshme për realizimin e projekteve të tyre të zhvillimit;

dhe duke marrë në konsideratë se Fondi është i bindur për qëndrueshmërinë dhe realizueshmërinë e projektit dhe rëndësinë e tij për zhvillimin e ekonomisë së Huamarrësit;

dhe duke marrë në konsideratë se Fondi, në zbatim sa më lart, ka rënë dakord t’i japë Huamarrësit një hua në bazë të kushteve dhe afateve në përmbajtje të kësaj Marrëveshjeje, rrjedhimisht, është rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Huaja dhe kushtet e saj

1. Fondi bie dakord t'i japë Huamarrësit huan bazë të kushteve dhe afateve të përcaktuara ose të përfshira me referencë në këtë Marrëveshje, një shumë të barasvlershme dyqind e dyzet milionë (240,000,000) dirhamë të Emirateve.

2. Huamarrësi paguan interes në normën e tre e gjysmëpër qind (3.5%) në vit, në bazë të shumës së principalit të huas së tërhequr dhe të papaguar. Interesi rritet nga datat përkatëse në të cilat do të tërhiqen shumat.

3. Huamarrësi paguan një tarifë të administrimit të huas në normën e zero pikë pesë për qind (0.5%) në vit mbi shumën e principalit të huas së tërhequr dhe të papaguar.

4. Tarifa e pagueshme për detyrime të veçanta financiare të kryera nga Fondi, me kërkesë të Huamarrësit sipas seksionit 2 të këtij neni 3, është në normën e zero pikë pesë për qind (0.5%) në vit mbi shumën e principalit të çdo detyrimi financiar të veçantë të papaguar herë pas here.

5. Interesi dhe tarifat e tjera llogariten mbi bazën e një viti 360 ditë me 12 muaj 30-ditorë për çdo periudhë më pak se gjashtë muaj.

6. Huamarrësi shlyen principalin e huas në përputhje me programin e amortizimit të përcaktuar në skedulin 1 të kësaj Marrëveshjeje, mbi bazën që periudha e shlyerjes të jetë 12 (dymbëdhjetë) vjet, e paraprirë nga tre (3) vjet si periudhë pa pagesë principal.

7. Interesi dhe tarifat e tjera janë të pagueshme çdo gjashtë muaj në datat 30 mars dhe 30 shtator të çdo viti.

8. Huamarrësi ka të drejtën, në bazë të pagesës së të gjithë interesit të shtuar dhe të gjitha tarifave të tjera, dhe pas dhënies së një njoftimi jo më pak se 45 ditë për Fondin, të shlyejë përpara maturimit:

- a) të gjithë shumën e principalit të huas që është e pashlyer deri në atë moment; ose
- b) të gjithë shumën e principalit të ndonjë ose më shumë maturiteteve, me kusht që në datën e parapagimit, nuk do të ketë pjesë të papaguar të huas që maturohet pas këtij parapagimi.

9. Principali dhe interesi, si dhe tarifat e tjera për huan paguhet në ato vende që do të kërkojë Fondi.

Neni 2

Dispozita mbi monedhën

1. Tërheqja e shumave të huas, shlyerja e saj, pagesa e interesit dhe tarifat e tjera, si dhe të gjitha llogaritë e transaksioneve financiare në lidhje me këtë Marrëveshje, do të jenë në dirhamë të Emirateve.

2. Me kërkesë të Huamarrësit dhe duke vepruar si agjent i tij, Fondi blen çdo monedhë që nevojitet nga Huamarrësi për pagesën ose rimbursimin e kostos së mallrave të financuara nga huaja, në përputhje me këtë Marrëveshje. Shuma që konsiderohet e tërhequr nga huaja në këtë rast do të jetë e barabartë me shumën e dirhamëve të Emirateve, të kërkuara për blerjen e kësaj monedhe të huaj.

3. Me kërkesë të Huamarrësit dhe duke vepruar si agjent i tij, Fondi blen atë shumë të dirhamëve të Emirateve që mund të kërkohet për shlyerjen, në përputhje me seksionin 1 të këtij neni, në çdo monedhë ose monedha të huaja të pranueshme për Fondin.

4. Kurdoherë që është e nevojshme për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, për të përcaktuar vlerën e një monedhe në lidhje me një tjetër, kjo vlerë do të përcaktohet në mënyrë të arsyeshme nga Fondi.



Neni 3

Tërheqja dhe përdorimi i shumave të huas

1. Huamarrësi është i autorizuar të tërheqë nga huaja shumat e shpenzuara ose që do të shpenzohen për projektin, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

2. Asnjë shumë nuk mund të tërhiqet nga huaja mbi bazën e shpenzimeve të shkaktuara përpara hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, nëse Fondi nuk bie dakord ndryshe.

3. Me kërkesë të Huamarrësit dhe në bazë të kushteve dhe afateve që do të bien dakord ndërmjet Huamarrësit dhe Fondit, Fondi mund të bëjë zotime të veçanta me shkrim për t'i paguar shumat Huamarrësit ose të tjerëve në lidhje me koston e mallrave që do të financohen sipas kësaj Marrëveshjeje, pavarësisht nga ndonjë pezullim ose anulim.

4. Kur Huamarrësi dëshiron të tërheqë një shumë nga huaja ose t'i kërkojë Fondit të bëjë një zotim të veçantë sipas seksionit pararendës, Huamarrësi i dërgon Fondit një kërkesë mbi format e parashikuara nga Fondi, të shoqëruar me dokumentet e nevojshme mbështetëse, megjithatë, në mënyrë që kur kryhet një tërheqje apo kur bëhet një zotim i veçantë përpara se kjo kërkesë ose këto dokumente mbështetëse t'i jenë paraqitur Fondit, ato të paraqiten menjëherë më pas.

5. Çdo kërkesë për tërheqje dhe dokumentet mbështetëse shoqëruese dhe prova të tjera duhet të jenë të mjaftueshme në formë dhe përmbajtje, në mënyrë që Fondi të bindet se Huamarrësi është i autorizuar të tërheqë nga huaja shumën e kërkuar dhe që shumat, e cila do të tërhiqet nga huaja të përdoret vetëm për qëllimet e përcaktuara në këtë Marrëveshje.

6. Huamarrësi përdor fondet e huas vetëm për financimin e kostove të arsyeshme të mallrave dhe shërbimeve të kërkuara për realizimin e projektit. Procedurat për prokurimin e këtyre mallrave dhe shërbimeve përcaktohen me marrëveshje ndërmjet Fondit dhe Huamarrësit.

7. Huamarrësi merr masa që mallrat e financuara nga fondet e huas të përdoren vetëm për realizimin e projektit.

8. Pagesa nga Fondi e shumave që Huamarrësi është i autorizuar të tërheqë nga huaja, kryhet për ose me urdhër të Huamarrësit.

9. E drejta e Huamarrësit për të bërë tërheqje nga huaja përfundon më 31.12.2016 ose në një datë tjetër që mund të bihet dakord herë pas here ndërmjet Huamarrësit dhe Fondit.

Neni 4

Zotime të veçanta

1. Huamarrësi i vë në dispozicion fondet e huas Përfituesit (Bashkia Tiranë) që do të ekzekutojë dhe operojë projektin sipas termave dhe kushteve të pranueshme nga Fondi.

2. Huamarrësi dhe Përfituesi i lartpërmendur ngarkohen për ekzekutimin dhe administrimin e projektit, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe kërkesat e menaxhimit të shërbimeve publike dhe me parimet e qëndrueshme inxhinierike, financiare dhe teknike.

3. Me synim zbatimin efektiv të projektit, Huamarrësi merr masat e nevojshme për krijimin nga Përfituesi, brenda gjashtë javëve nga data e Marrëveshjes, ose në një datë tjetër që mund të bihet dakord me Fondin, të njësisë së menaxhimit të projektit (NJMP), e cila do të jetë përgjegjëse për administrimin e ekzekutimit të projektit. NJMP-ja kryesohet nga një menaxher i kualifikuar dhe me përvojë, i pranueshëm për Fondin, dhe përbëhet nga personel lokal i mjaftueshëm teknik, për çështjet e kontabilitetit dhe çështjet administrative, i pëlqyeshëm nga Fondi. Në interesin më të mirë të projektit, Huamarrësi merr masa që Përfituesi t'i japë NJMP-së burime të mjaftueshme, financim dhe shërbime dhe e autorizon atë me përgjegjësitë e nevojshme për të garantuar se bashkërendimi i duhur dhe kontaktet e nevojshme janë mbajtur për zbatimin e suksesshëm të punimeve të projektit.

4. Përfituesi cakton konsulentë inxhinierikë (ose konsulentë të tjerë që mund të kërkojnë), të pranueshëm për mbikëqyrjen dhe realizimin e projektit.

5. Huamarrësi/Përfituesi i japin Fondit kopje të vërtetuara të të gjitha kontratave të lidhura përpara datës së kësaj Marrëveshjeje në lidhje me projektin.

6. Lidhja e kontratave për ekzekutimin dhe supervizimin e projektit do të jenë subjekt i procedurave ndërkombëtare konkurruese dhe aprovimit të Fondit.

7. Huamarrësi/Përfituesi merr masat e nevojshme për fitimin e pronësisë së tokës ose të të drejtave mbi të, sipas kërkesave të ekzekutimit të projektit.

8. Huamarrësi/Përfituesi i dorëzojnë konsulentit inxhinierik dhe kontraktorit sheshin e projektit, të lirë nga të gjitha barrët dhe garanton të drejtën e përdorimit të tij.

9. Nëse ndodh që shumat e alokuara për financimin e projektit janë më të vogla sesa kostoja e llogaritur e ekzekutimit, Huamarrësi merr hapat që mund të jenë të nevojshëm për dhënien e shumave shtesë të kërkuara për realizimin e ekzekutimit, në termat dhe kushtet e aprovuara parapakisht nga Fondi.

10. Përfituesi i jep Fondit të gjitha studimet e fizibilitetit, planet dhe specifikimet e projektit, si dhe çdo ndryshim material të bërë ose që duhet të bëhet në to, në atë mënyrë që Fondi kërkon herë pas here.

11. Huamarrësi mundëson ose merr masa për ruajtjen e të dhënave të mjaftueshme për identifikimin e mallrave dhe shërbimeve të financuara nga të ardhurat e huas dhe njofton përdorimin e tyre në projekt, për të treguar ecurinë e projektit (duke përfshirë koston e tij), dhe për të reflektuar, në përputhje me procedurat përkatëse që respektojnë praktikën e qëndrueshme dhe të mirëcaktuara të kontabilitetit, operacionet dhe gjendjen financiare të autoritetit që është duke realizuar projektin. Huamarrësi/Përfituesi u ofron të gjitha mundësitë përfaqësuesve të akredituar të Fondit të kryejnë vizita për qëllime në lidhje me huan, dhe për të inspektuar ecurinë e punës, si dhe për të shqyrtuar të dhënat dhe dokumentet përkatëse, dhe i jep Fondit të gjithë informacionin që Fondi do të kërkojë në lidhje me shpenzimin e të ardhurave të huas, ekzekutimin e projektit dhe gjendjen financiare të Huamarrësit.

12. Huamarrësi merr përsipër direkt ose indirekt të drejtë dhe vazhdojë Projektin në përputhje me standardet ndërkombëtare inxhinierike, financiare dhe teknike.

13. Huamarrësi dhe Fondi bashkëpunojnë plotësisht për të garantuar përmbushjen e qëllimeve të huas. Për këtë qëllim, çdo palë merr përsipër t'i japë tjetrës atë informacion dhe deklarata që mund të kërkojë në lidhje me gjendjen e përgjithshme të huas. Huamarrësi dhe Fondi shkëmbejnë herë pas here mendime nëpërmjet përfaqësuesve të tyre mbi çështje që lidhen me qëllimet e huas dhe vazhdimin e shërbimeve të saj. Huamarrësi informon menjëherë Fondin për çdo gjendje që ndërhyrë ose rrezikon të ndërhyjë në realizimin e qëllimit të huas (duke përfshirë çdo rritje të dukshme në koston e projektit).

14. Synimi reciprok i Huamarrësit dhe Fondit është që asnjë borxh tjetër i jashtëm nuk do të gëzojë prioritet mbi huan me anë të një barre të krijuar më pas mbi asetet qeveritare. Për këtë qëllim, Huamarrësi merr përsipër që, nëse Fondi nuk bie dakord ndryshe, nëse do të krijohet një barrë mbi asetet e Huamarrësit si garanci për këtë borxh të jashtëm, kjo barrë *ipso facto* do të sigurojë edhe proporcionalisht pagesën e principalit dhe interesit dhe tarifa të tjera mbi huan, dhe se në krijimin e kësaj barre, nuk do të merret asnjë masë e shprehur për këtë qëllim, megjithatë, me kusht që dispozitat e mësipërme të këtij seksioni të mos zbatohen për:

a) asnjë barrë të krijuar mbi pronën në kohën e blerjes së saj vetëm si garanci për pagesën e çmimit të blerjes së kësaj prone;

b) asnjë barrë mbi mallrat tregtare për të garantuar maturimin e një borxhi jo më shumë se një vit pas datës në të cilën është shkaktuar fillimisht dhe që duhet të paguhet nga të ardhurat e shitjes së këtyre mallrave tregtare; ose

c) asnjë barrë që lind gjatë ushtrimit të zakonshëm të transaksioneve bankare dhe garantimit të maturitetit të një borxhi jo më shumë se një vit pas datës së tij.



15. Principali dhe interesi mbi huan dhe të gjitha tarifat e tjera paguhen pa zbritje dhe janë të lira nga çdo taksë në fuqi sipas ligjeve të Huamarrësit.

16. Kjo Marrëveshje është e lirë nga taksat, tarifat dhe detyrimet e çdo natyre që mund të vendosen sipas ligjeve në fuqi në vendin e Huamarrësit në ose në lidhje me ekzekutimin, dorëzimin ose regjistrimin e tij, dhe Huamarrësi paguan ose merr masa për pagimin e të gjitha taksave, tarifave dhe detyrimeve, nëse ka, të vendosura sipas ligjeve në fuqi në çdo vend në të cilin është e pagueshme monedha e huas.

17. Principali dhe interesi, si dhe tarifat e tjera mbi huan paguhen të lira nga të gjitha detyrimet e vendosura sipas ligjeve në fuqi në vendin e Huamarrësit.

18. Huamarrësi garanton ose merr masa për të garantuar që të gjitha mallrat e financuara nga të ardhurat e huas të sigurohen nga një prej kompanive të aprovuara të sigurimeve, kundër të gjitha rreziqeve në lidhje me blerjen, importimin e mallrave në territoret e Huamarrësit dhe dorëzimin e tyre në sheshin e projektit, dhe për ato shuma që janë të pajtueshme me praktikën e qëndrueshme tregtare. Kjo garanci do të jetë e pagueshme në monedhën në të cilën mallrat e siguruara janë blerë ose në monedhë lirisht të konvertueshme.

19. Huamarrësi merr të gjitha masat ose ndihmon për marrjen e të gjitha masave që do të jenë të nevojshme nga ana e tij për ekzekutimin e projektit dhe nuk merr ose nuk lejon marrjen e asnjë mase që do të pengonte ose ndërhynte në ekzekutimin ose operimin e projektit, ose realizimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

20. Të gjitha dokumentet e Fondit, të dhënat, korrespondenca dhe materiale të ngjashme, konsiderohen nga Huamarrësi si çështje konfidenciale. Huamarrësi i jep Fondit imunitet të plotë nga censurimi dhe inspektimi i publikimeve.

21. Të gjitha asetet dhe të ardhurat e Fondit lehtësohen nga shtetëzimi, konfiskimi dhe sekuestrimi.

Neni 5

Anulimi dhe pezullimi

1. Me anë të një njoftimi për Fondin, Huamarrësi mund të anulojë çdo shumë të huas që Huamarrësi nuk ka tërhequr përpara dhënies së këtij njoftimi, me përjashtim të rastit kur Huamarrësi nuk mund ta anulojë këtë shumë të huas, në lidhje me të cilën Fondi ka bërë një zotim të veçantë sipas seksionit 2 të nenit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

2. Nëse ka ndodhur dhe vazhdon ndonjë prej rasteve të mëposhtme, me anë të një njoftimi për Huamarrësin, Fondi mund të pezullojë tërësisht ose pjesërisht të drejtën e Huamarrësit për të bërë tërheqje nga huaja:

a) Kur ka ndodhur mosplotësim i plotë ose i pjesshëm i pagesës së principalit, ose interesit, ose i çdo pagese tjetër të kërkuar sipas kësaj Marrëveshjeje, ose çdo marrëveshjeje tjetër huaje ndërmjet Huamarrësit dhe Fondit;

b) Kur ka ndodhur një mosplotësim i ndonjë zotimi apo marrëveshjeje tjetër nga ana e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje;

c) Kur Fondi ka pezulluar tërësisht ose pjesërisht të drejtën e Huamarrësit për të bërë tërheqje sipas ndonjë marrëveshjeje tjetër huaje ndërmjet Huamarrësit dhe Fondit për shkak të një mosplotësimi detyrimesh nga ana e Huamarrësit;

d) Kur ka lindur një situatë e jashtëzakonshme, e cila bën të pamundur që Huamarrësi të jetë i aftë të përmbushë detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje. Çdo rast i tillë që mund të ketë ndodhur pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, do të ketë të njëjtin ndikim që do të kishte pasur nëse do të kishte ndodhur pas tij.

3. E drejta e Huamarrësit për të bërë tërheqje sipas huas do të vazhdojë të pezullohet tërësisht ose pjesërisht, sipas rastit, derisa rasti ose rastet që shkaktuan këtë pezullim do të kenë pushuar së ekzistuari ose derisa Fondi të ketë njoftuar Huamarrësin se e drejta për të bërë tërheqje

është rivendosur, megjithatë, me kusht që në rastin e një njoftimi rivendosjeje, e drejta për bërjen e tërheqjeve do të rivendoset vetëm në masën dhe në bazë të kushteve të përcaktuara në këtë njoftim, dhe asnjë njoftim i tillë nuk do të cenojë ose dëmtojë të drejtat, kompetencat ose mjetet ligjore të Fondit në lidhje me çdo rast tjetër të mëtejshëm të përshkruar në këtë seksion.

4. Nëse ndonjë rast i përcaktuar në paragrafin “a” të seksionit pararendës do të ketë ndodhur dhe vazhdon për një periudhë prej gjashtëdhjetë ditësh, pasi njoftimi përkatës të jetë dhënë nga Fondi për Huamarrësin, ose nëse ndonjë rast i përcaktuar në paragrafët “b”, “c” dhe “d” të seksionit të lartpërmendur do të ketë ndodhur dhe do të ketë vazhduar për një periudhë prej nëntëdhjetë ditësh pasi njoftimi për këtë të jetë dhënë nga Fondi për Huamarrësin, atëherë në çdo kohë të mëtejshme gjatë vazhdimit të tij, Fondi, sipas zgjedhjes së vet, mund të shpallë principalin e huas të kërkueshëm dhe të pagueshëm në mënyrë të menjëhershme; dhe pas kësaj deklarate ky principal do të bëhet menjëherë i kërkueshëm dhe i pagueshëm, pavarësisht nga ndonjë element në kundërshtim me këtë Marrëveshje.

5. Nëse: a) e drejta e Huamarrësit për të bërë tërheqje nga huaja do të jetë pezulluar në lidhje me çdo shumë të saj për një periudhë të vazhdueshme prej tridhjetë ditësh; ose b) deri në datën e përcaktuar në seksionin 8 të nenit 3 si data e mbylljes, një shumë e huas do të mbetet e patërhequr, Fondi, me anë të një njoftimi drejtuar Huamarrësit, mund t’i japë fund të drejtës së Huamarrësit për të bërë tërheqje në lidhje me këtë shumë. Pas dhënies së këtij njoftimi, kjo shumë e huas do të anulohet.

6. Asnjë anulim ose pezullim nga Fondi nuk zbatohet për shumat që u nënshtrohen ndonjë zotimi të veçantë të bërë nga Fondi sipas seksionit 2 të nenit 3, përveç rasteve kur parashikohet shprehimisht në këtë zotim.

7. Çdo anulim zbatohet proporcionalisht për disa maturitete të shumës së principalit të huas, siç përcaktohet në skedulën e amortizimit të kësaj Marrëveshjeje.

8. Pavarësisht nga ndonjë anulim ose pezullim, të gjitha dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të vazhdojnë të jenë në fuqi dhe efekt të plotë, përveç kur parashikohet shprehimisht në këtë nen.

Neni 6

Zbatueshmëria e kësaj Marrëveshjeje; pamundësia për ushtrimin e të drejtave; arbitrazhi

1. Të drejtat dhe detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje janë të vlefshme dhe të zbatueshme në përputhje me kushtet e tyre, pavarësisht nga ndonjë ligj i brendshëm në kundërshtim. As Huamarrësi, as Fondi nuk janë të autorizuar, në asnjë rrethanë, të shpallin pretendime që ndonjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje është e pavlefshme ose e pazbatueshme për asnjë lloj rrethane.

2. Pamundësia për ushtrimin e ndonjë të drejte ose kompetence të dhënë për secilën palë nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk e pengon atë ta ushtrojë këtë të drejtë ose kompetencë në çdo kohë të mëtejshme dhe nuk interpretohet si heqje dorë prej saj. Në mënyrë të ngjashme, asnjë lëshim i treguar nga një palë në lidhje me ndonjë mosplotësim detyrimesh nga pala tjetër e përjashton atë që të drejtohet më tej për çdo veprim në dispozicion të saj sipas kësaj Marrëveshjeje në lidhje me këtë mosplotësim detyrimesh.

3. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të kësaj Marrëveshjeje dhe çdo pretendim nga një palë kundër tjetrës që lind sipas kësaj Marrëveshjeje, përfundon me anë të një marrëveshjeje miqësore. Nëse nuk është arritur asnjë marrëveshje e tillë, mosmarrëveshja ose pretendimi referohen për zgjidhje nga një gjykatë arbitrazhi, në përputhje me dispozitat e mëposhtme të këtij neni.

a) Gjykata e Arbitrazhit përbëhet nga tre arbitra, ku një caktohet nga Huamarrësi dhe një nga Fondi. Arbitri i tretë (më poshtë i quajtur gjyqtari i arbitrazhit) caktohet me marrëveshje ndërmjet palëve. Nëse të dyja palët nuk kanë rënë dakord brenda 60 ditësh nga fillimi i procedimeve të arbitrazhit për gjyqtarin e arbitrazhit, ky i fundit do të caktohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Ligës Arabe ose nga çdo organizatë tjetër ndërkombëtare të pranueshme nga të dyja palët. Nëse një



palë nuk ka mundur të caktojë arbitrin e vet brenda 30 ditësh nga fillimi i procedimeve të arbitrazhit, Sekretari i Përgjithshëm i Ligës Arabe ose organizata ndërkombëtare do ta caktojë atë, me kërkesë të palës tjetër. Në rast të heqjes dorë, vdekjes ose paaftësisë për të vepruar të ndonjë arbitri, një pasardhës caktohet në të njëjtën mënyrë në të cilën është zgjedhur arbitri i parë.

b) Procedimet e arbitrazhit mund të fillohen nga çdo palë që i jep tjetrës njoftim, i cili përmban një deklaratë të qartë të natyrës së mosmarrëveshjes ose pretendimit që do t'i paraqitet arbitrazhit, natyrën dhe masën e kompensimit të kërkuar, dhe emrin e arbitrit të caktuar nga pala që fillon procedimet e arbitrazhit. Brenda tridhjetë ditësh pas dhënies së këtij njoftimi, pala kundërshtare do të njoftojë tjetrën për emrin e arbitrit të vet. Gjykata e Arbitrazhit mblidhet në atë kohë dhe vend që caktohet nga gjyqtari i arbitrazhit. Më pas, Gjykata e Arbitrazhit cakton vendin dhe kohën kur do të mblidhet.

c) Gjykata e Arbitrazhit përcakton procedurën e vet, në mënyrë që secilës palë t'i ofrohet një seancë e drejtë. Gjykata e Arbitrazhit mund të përcaktojë çështjet para saj ose në prani të palëve, ose në mungesë. Të gjitha vendimet e saj janë me shumicë votash. Vendimi jepet me shkrim dhe nënshkruhet të paktën nga një shumicë e Gjykatës së Arbitrazhit. Një kopje e nënshkruar e vendimit i dërgohet secilës palë. Çdo vendim i tillë i dhënë në përputhje me dispozitat e këtij neni, është i formës së prerë dhe detyrues për palët e kësaj Marrëveshjeje. Çdo palë i përmbahet dhe pajtohet me këtë vendim të dhënë nga Gjykata e Arbitrazhit.

d) Gjykata e Arbitrazhit zbaton parimet e përbashkëta sipas ligjeve aktuale të Huamarrësit dhe shtetit të Emirateve të Bashkuara Arabe, si dhe në bazë të parimeve të drejtësisë dhe ndërgjegjes së mirë.

e) Çdo palë paguan shpenzimet e saj në procedimet e arbitrazhit, duke përfshirë tarifat e arbitrit të caktuar prej saj. Shpenzimet e Gjykatës së Arbitrazhit dhe tarifat e Gjyqtarit të Arbitrazhit ndahen midis përballohen në mënyrë të barabartë nga palët. Asnjë çështje në lidhje me ndarjen e shpenzimeve të Gjykatës së Arbitrazhit ose procedura për pagesën e këtyre shpenzimeve nuk përcaktohet nga Gjykata e Arbitrazhit.

4. Dispozitat për arbitrazhin, të parashtruara në seksionin e mëparshëm, zëvendësojnë çdo procedurë tjetër për përcaktimin e mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve të kësaj Marrëveshjeje dhe çdo pretendim nga një palë kundër palës tjetër që lind sipas saj.

5. Dërgimi i çdo njoftimi ose kryerja e çdo procesi në lidhje me ndonjë procedim sipas këtij neni, mund të bëhet në të njëjtën mënyrë që parashikohet në seksionin 1 të nenit 7.

Neni 7

Dispozita të ndryshme

1. Çdo njoftim ose kërkesë, e kërkuar dhe e lejuar të jepet ose të bëhet sipas kësaj Marrëveshjeje, do të jetë me shkrim. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në seksionin 3 të nenit 8, ky njoftim ose kjo kërkesë do të konsiderohen të jenë dhënë ose bërë sipas rregullave kur i dërgohen dorazi, me postë ose telegram, palës së cilës kërkohet ose lejohet t'i jepet ose bëhet, në adresën e kësaj pale të përcaktuar në këtë Marrëveshje ose në çdo adresë tjetër që kjo palë do të ketë përcaktuar me anë të një njoftimi drejtuar palës tjetër.

2. Huamarrësi i jep Fondit prova të mjaftueshme të autoritetit të personit ose personave, të cilët do të nënshkruajnë kërkesat e parashikuara në nenin 3 ose që në emër të Huamarrësit, do të marrin çdo masë tjetër ose do të ekzekutojnë çdo dokument tjetër të kërkuar ose që lejohet të merret ose ekzekutohet nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje, dhe modelin e nënshkrimit të vërtetuar të secilit prej këtyre personave.

3. Çdo veprim që kërkohet ose lejohet të bëhet dhe çdo dokument që kërkohet ose lejohet të ekzekutohet sipas kësaj Marrëveshjeje në emër të Huamarrësit, mund të bëhet ose ekzekutohet nga Ministri i Financave i Huamarrësit ose çdo person i autorizuar me shkrim nga ai sipas kësaj

Marrëveshjeje. Çdo ndryshim ose zgjerim i dispozitave të kësaj Marrëveshjeje mund të miratohet në emër të Huamarrësit me anë të një dokumenti me shkrim të nënshkruar në emër të Huamarrësit nga përfaqësuesi i tij i lartpërmendur ose çdo person i autorizuar me shkrim nga ai sipas kësaj marrëveshjeje, me kusht që sipas mendimit të këtij përfaqësuesi, ky ndryshim ose zgjerim të jetë i arsyeshëm sipas rrethanave dhe të mos rrisë dukshëm detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje. Fondi mund të pranojë ekzekutimin nga ky përfaqësues ose person tjetër të çdo instrumenti të tillë si provë përfundimtare, që sipas mendimit të këtij përfaqësuesi, çdo ndryshim ose zgjerim i dispozitave të kësaj Marrëveshjeje të kryera nga ky instrument është i arsyeshëm sipas rrethanave dhe nuk do të rrisë dukshëm detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje.

4. Çdo marrëveshje e veçantë e shkëmbyer ndërmjet palëve në lidhje me ose sipas kësaj Marrëveshjeje do të jetë detyruese për të njëjtin efekt sikur të përfshiheshin në të.

5. Gjuha mbizotëruese, sipas të cilës duhet të interpretohet kjo marrëveshje, është gjuha arabe.

Neni 8

Data e hyrjes në fuqi, përfundimi

1. Kjo Marrëveshje nuk hyn në fuqi derisa Fondit t'i jenë dhënë prova të mjaftueshme se:
a) vlerësimi i projektit nga Fondi dhe dërgimi i raportit përfundimtar të vlerësimit në Bordin e Drejtoreshave të Fondit për miratim nga ana e tyre.

b) ekzekutimi dhe përmbushja e kësaj Marrëveshjeje në emër të Huamarrësit janë autorizuar dhe miratuar sipas rregullave nga i gjithë veprimi kushtetues i nevojshëm.

2. Si pjesë e provave që do të jepen sipas seksionit pararendës, Huamarrësi i jep Fondit një opinion të një autoriteti kompetent që tregon se kjo Marrëveshje është autorizuar ose miratuar sipas rregullave, dhe është ekzekutuar dhe dorëzuar në emër të Huamarrësit, dhe përbën një detyrim ligjor dhe detyrues të Huamarrësit në përputhje me kushtet e saj.

3. Nëse Fondi bindet me provat e dhëna nga Huamarrësi në lidhje me efektin detyrues të kësaj Marrëveshjeje, Fondi i dërgon Huamarrësit njoftim me anë të një shkrese zyrtare për pranimin nga ana e tij të provave të kërkuara nga seksioni 1 i këtij neni. Kjo Marrëveshje do të jetë efektive dhe do të hyjë në fuqi në datën në të cilën është dërguar kjo shkrese.

4. Nëse të gjitha aktet që kërkohen të kryhen sipas seksionit 1 të këtij neni nuk janë realizuar përpara 120 ditëve pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje ose një date tjetër që bihet dakord nga Fondi dhe Huamarrësi në çdo kohë më pas, Fondi, me zgjedhjen e vet, mund t'i japë fund kësaj Marrëveshjeje me anë të njoftimit drejtuar Huamarrësit. Pas dhënies së këtij njoftimi, kjo Marrëveshje dhe të gjitha detyrimet e palëve sipas saj do të përfundojnë menjëherë.

5. Nëse dhe kur e tërë shumat e principalit të huas dhe i gjithë interesi dhe tarifat e tjera që do të jenë shtuar mbi huan do të jenë paguar, kjo Marrëveshje dhe të gjitha detyrimet e palëve sipas saj, do të përfundojnë menjëherë.

Neni 9

Përkufizimet

1. Përveç rasteve kur konteksti e kërkon ndryshe, termat e mëposhtëm kanë kuptimet e mëposhtme sa herë që përdoren në këtë Marrëveshje ose skedul të saj:

a) Termi “projekt” nënkupton projektin ose projektet, ose programin ose programet për të cilat është dhënë huaja, siç përshkruhet në skedulën 2 të kësaj Marrëveshjeje dhe siç ndryshohet përshkrimi i saj herë pas here me marrëveshje ndërmjet Fondit dhe Huamarrësit.

b) Termi “mallra” nënkupton pajisjet, furnizimet dhe shërbimet që kërkohen për projektin. Sa herë që i referohet koston së mallrave, kjo kosto konsiderohet të përfshijë koston e importimit të këtyre mallrave në territoret e Huamarrësit.

Adresat e mëposhtme caktohen për qëllime të nenit 7 të seksionit 1:



Për Huamarrësin:
Ministria e Financave
Tiranë Republika e Shqipërisë
Tel.: +355 4 2228405
Faks: +355 4 229200
Për Fondin:
Fondi Abu Dhabi për Zhvillim
P.O.Box 814, Abu Dhabi, U.A.E
Tel: + 971 – 2-6677100
Fax: + 971-2-6677070

Në dëshmi të kësaj, palët e kësaj Marrëveshjeje, që veprojnë nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, kanë nënshkruar dhe dorëzuar këtë Marrëveshje në emrin e tyre përkatës në Abu Dhabi në tri kopje, ku secila konsiderohet një origjinal dhe ku të gjitha janë për një efekt të njëjtë dhe të vetëm, në ditën dhe vitin e shkruar fillimisht më sipër.

Për Huamarrësin
MINISTRI I FINANCIVE
Ridvan Bode

SKEDULI 1
SKEDULI I AMORTIZIMIT

Projekti i bulevardit verior dhe rehabilitimi i lumit të Tiranës

Numri i shlyerjeve	Data e kësteve të pagueshme	Shuma totale e kësteve të pagueshme në AED
1.	30.4.2016	10,000,000,00
2.	30.10.2016	10,000,000,00
3.	30.4.2017	10,000,000,00
4.	30.10.2017	10,000,000,00
5.	30.4.2018	10,000,000,00
6.	30.10.2018	10,000,000,00
7.	30.4.2019	10,000,000,00
8.	30.10.2019	10,000,000,00
9.	30.4.2020	10,000,000,00
10.	30.10.2020	10,000,000,00
11.	30.4.2021	10,000,000,00
12.	30.10.2021	10,000,000,00
13.	30.4.2022	10,000,000,00
14.	30.10.2022	10,000,000,00
15.	30.4.2023	10,000,000,00
16.	30.10.2023	10,000,000,00
17.	30.4.2024	10,000,000,00
18.	30.10.2024	10,000,000,00
19.	30.4.2025	10,000,000,00
20.	30.10.2025	10,000,000,00
21.	30.4.2026	10,000,000,00
22.	30.10.2026	10,000,000,00
23.	30.4.2027	10,000,000,00
24.	30.10.2027	10,000,000,00
TOTALI		240,000,000.00

Totali 240,000,000
AED vetëm dyqind e dyzet milionë

SKEDULI 2
OBJEKTIVAT DHE PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Objektivat e projektit

Projekti synon të kontribuojë në procesin e zhvillimit ekonomik të vendit nëpërmjet implementimit të projektit të bulevardit verior dhe rehabilitimit të lumit të Tiranës, projekt shumë i rëndësishëm për qytetin e Tiranës.

Përshkrimi i projektit

Projekti konsiston në ndërtimin e strukturave të mëposhtme:

- Rehabilitimi i lumit të Tiranës dhe zonave përreth;
- Ndërtimi i bulevardit verior të Tiranës dhe punimeve përkatëse civile;
- Përgatitja e infrastrukturës në zhvillimin e turizmit dhe lehtësirave, ndërtimi i strukturave

të zhvillimit tregtar

Lista e mallrave

Përshkrimi: Shuma AED, përqindja %

Seksioni 1: Punimet për rehabilitimin e lumit të Tiranës dhe strukturave shoqëruese civile, 90 000 000, 50 %

Seksioni 2: Ndërtimi i bulevardit verior të Tiranës dhe punimeve civile shoqëruese, 120 000,000, 50 %

Seksioni 2: Shërbim konsulence, supervizion 10,000,000

Seksioni 4: Kontigjencë 20,000,000

Totali: 240,000,000

VENDIM

Nr. 332, datë 18.4.2013

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË TREGTIMIT E TË CERTIFIKIMIT TË FARAVE
TË PERIMEVE¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 pika 9, 14 pika 3, 15 pika 3, e 16 pika 4 të ligjit nr. 10 416, datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. TË PËRGJITHSHME DHE PËRKUFIZIME

I.1 Qëllimi dhe zbatimi

1. Qëllimi i këtij vendimi është të përcaktojë kriteret për tregtimin e farës së perimeve, për kategoritë, identitetin dhe cilësinë e tyre, rregullat e paketimit e të etiketimit, si dhe procedurat e kriteret e certifikimit.

Objektivat e projektit

2. Ky vendim zbatohet për speciet e bimëve perimore, të listuara në aneksin I/1, bashkëlidhur këtij vendimi.

I.2 Përkufizime

Të gjithë termat e përcaktuar në ligjin nr. 10 416, datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë vendim, ndërsa me termat e mëposhtëm do të nënkuptohen:

1. “Perime”, bimë të specieve të destinuara për prodhim bujqësor ose për kopshtari, por jo për përdorim zbukurues, sipas aneksit I/1, bashkëlidhur këtij vendimi, si më poshtë vijon:

¹ *Direktiva e Këshillit nr. 2002/55/EC, datë 13 qershor 2002 “Për tregtimin e farave të perimeve”, celex nr. 32002L0055OJ L 193, datë 20.7.2002.



a) 5 kg, për bimët perimore bishtajore;
b) 500 g, për qepët, chervilin, asparagun, pazinë, panxharin e kuq, turnipin, shalqirin, kungulleshkat, kungullin e zakonshëm, karotat, rrepkat, endiviet, spinaqin, sallatën jeshile gjethevogël;

c) 100 g, për speciet e tjera të perimeve.

2. “Komponent”, njëri nga prindërit që shërben për përftimin e farës hibride.

3. “Farë hibride”, fara që përftohet nga kryqëzimi i dy apo më shumë komponentëve.

II. KRITERET PËR TREGTIMIN E FARAVE TË PERIMEVE

II.1 Kërkesa të përgjithshme për tregtimin e farës së perimeve

II.1.1 Kriteria për tregtimin e farës

1. Farat e perimeve për tregtim duhet të plotësojnë këto kritere:

a) Të kenë të përcaktuar kategorinë, identitetin dhe cilësinë, sipas kërkesave të këtij vendimi dhe aneksit II të tij;

b) Të jenë certifikuar dhe të plotësojnë kushtet e përcaktuara në aneksin I, bashkëlidhur këtij vendimi;

c) Për rastet e prodhimit vendas, të jenë pajisur me certifikatën zyrtare sipas modelit të përcaktuar në aneksin VI, bashkëlidhur këtij vendimi;

ç) Të jenë paketuar dhe etiketuar në përputhje me kriteret e këtij vendimi;

d) Varieteti ose hibridi të jetë i regjistruar në Katalogun Kombëtar;

dh) Të plotësojnë kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e bimëve dhe atij për mbrojtjen e biodiversitetit;

e) Të plotësojnë kushtet e magazinimit, ruajtjes dhe transportit.

2. Fara e specieve perimore, përjashtuar çikoren industriale, nuk mund të tregtohet nëse nuk është certifikuar zyrtarisht si farë bazë ose farë e certifikuar ose nëse nuk është farë standarde.

3. Fara e çikores industriale nuk mund të tregtohet nëse ajo nuk është certifikuar zyrtarisht si farë bazë ose farë e certifikuar.

4. Pavarësisht nga pikat 2 dhe 3 të këtij kreu, mund të tregtohet:

a) fara e seleksionerit e gjeneracioneve para farës bazë;

b) fara e prodhuar, tregtuar për përpunim, me kusht që të jetë siguruar identiteti i farës.

5. Kushtet, që duhet të plotësojë fara sipas shkronjës “a” të pikës 4, për t’u tregtuar, janë si më poshtë vijon:

a) Të jetë kontrolluar zyrtarisht nga autoriteti certifikues, në përputhje me procedurën e certifikimit të farës bazë;

b) Të jetë paketuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë vendim;

c) Paketat duhet të pajisen me etiketë zyrtare në të cilën të jenë përcaktuar:

i) autoriteti certifikues dhe shteti përkatës ose shkurtime të tyre dalluese;

ii) numri i referencës së lotit;

iii) muaji dhe viti i paketimit;

iv) muaji dhe viti i marrjes së mostrës së fundit zyrtare, për qëllime certifikimi;

v) speciet, të treguara të paktën nën emrin e tyre botanik, të cilat mund të jenë dhënë në formë të shkurtuar dhe pa emrat e autorëve, në shkronja romake;

vi) varieteti, i treguar të paktën me shkronja romake;

vii) përshkrimi i farës parabazë;

viii) numri i gjeneracionit që i paraprin farës së kategorisë “farë e certifikuar”.

ç) Etiketa të jetë e bardhë me një vijë diagonale në ngjyrë violet.

II.1.2 Kategoritë, identiteti dhe cilësia e farave të perimeve

1. Sipas prejardhjes, farat e perimeve ndahen në kategoritë e mëposhtme:

a) Fara parabazë;

b) Fara bazë;

- c) Fara e certifikuar;
- ç) Fara standarde.
- 2. Fara parabazë është fara që është prodhuar nën përgjegjësinë e seleksionerit, sipas praktikave të pranura për prodhimin e farave të kësaj kategorie. Kjo farë është burim për prodhimin e farës bazë.
- 3. Fara bazë është fara që:
 - a) është prodhuar nën përgjegjësinë e seleksionerit, sipas praktikave të pranura për mirëmbajtjen e varietetit;
 - b) është menduar për prodhimin e farës së kategorisë “farë e certifikuar”;
 - c) plotëson kushtet e përcaktuara në anekset I dhe II, bashkëlidhur këtij vendimi, për farën bazë;
 - ç) nga kontrolli zyrtar rezulton se plotëson kushtet e përcaktuara në aneksin II, bashkëlidhur këtij vendimi, dhe kërkesat e përcaktuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të kësaj pike.
- 4. Fara e certifikuar është fara që:
 - a) është prodhuar direkt nga fara bazë ose, nëse seleksioneri e kërkon, nga fara e një brezi para farës bazë dhe që plotëson kushtet e përcaktuara në anekset I dhe II, bashkëlidhur këtij vendimi, për farën bazë;
 - b) përdoret kryesisht për prodhimin e perimeve;
 - c) plotëson kushtet e përcaktuara në anekset I dhe II, bashkëlidhur këtij vendimi, për farën e certifikuar;
 - ç) nga kontrolli zyrtar ose nga mbikëqyrja zyrtare rezulton se plotëson kushtet e përcaktuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të kësaj pike;
 - d) është objekt i postkontrolleve zyrtare, për të verifikuar identitetin dhe pastërtinë varietore.
- 5. Fara standarde është fara që:
 - a) ka mjaftueshmërisht identitet dhe pastërti varietore;
 - b) përdoret kryesisht për prodhimin e perimeve;
 - c) plotëson kushtet e përcaktuara në aneksin II, bashkëlidhur këtij vendimi;
 - ç) është objekt i postkontrolleve zyrtare, për të verifikuar identitetin dhe pastërtinë varietore.
- 6. Skemat e prodhimit të kategorive të farave të perimeve, sipas grupimit të tyre, bëhen nën monitorimin dhe përgjegjësinë e ESHFF-së.
- 7. Identiteti i farave të perimeve është tërësia e veçorive botanike, biologjike dhe morfologjike që zotëron një varietet, vlera e të cilave është e njohur dhe plotëson qëllimet e përdorimit.
- 8. Cilësia e farës së perimeve përcaktohet nga këta tregues:
 - a) Pastërtia e përgjithshme, që është përqindja e farave të pastra ndaj peshës së përgjithshme të farës;
 - b) Fuqia mbirëse, që është aftësia e farës për të mbirë në kushte të caktuara dhe përcaktohet nga numri i farave që mbijnë në raport me numrin e farave të vëna për mbirje;
 - c) Energjia mbirëse që është aftësia që ka fara për të mbirë brenda një periudhe kohe të caktuar;
 - ç) Lagështia e farave, që është përqindja e lejuar e lagështirës që mbart fara, për t’u paketuar dhe për t’u tregtuar si material mbjellës.
- II.1.3 Kriteret për kontrollin e tregtimit të farave të perimeve
 - 1. Kontrollat zyrtare në lidhje me tregtimin e farës së perimeve duhet të jenë kryer të paktën nga kontrolle të rastit, për të verifikuar plotësimin e kërkesave e të kushteve të përcaktuara në këtë vendim.
 - 2. Në paketimin gjatë tregtimit të sasive, që kalojnë dy kilogramë farë të importuar, duhet të përcaktohen të dhënat e mëposhtme:
 - a) speciet;



- b) varieteti;
- c) kategoria;
- ç) vendi i prodhimit dhe autoriteti i kontrollit zyrtar;
- d) vendi i dërgimit;
- dh) importuesi;
- e) sasia e farës.

3. Mënyra në të cilën do të paraqiten këto të dhëna përcaktohet me udhëzim të ministrit.

4. Fara e kategorive “farë e certifikuar” dhe “farë standarde” i nënshtrohet postkontrollit zyrtar në fushë, për të krahasuar identitetin dhe pastërtinë e tyre varietore ndaj kontrolleve.

5. Nëse gjatë testeve të postkontrollit të kryera në fushë rezulton në mënyrë të përsëritur se fara e varietetit nuk plotëson kushtet e përcaktuara në lidhje me identitetin dhe pastërtinë varietore, furnizuesi nuk lejohet të tregtojë një farë të tillë për një periudhë të caktuar.

6. Çdo masë e marrë sipas pikës 5 hiqet në momentin që vërtetohet se fara e destinuar për tregtim në të ardhmen plotëson kushtet për identitetin dhe pastërtinë varietore.

7. Testet dhe provat krahasuese për ekzaminimin e postkontrollit të mostrave të farës së perimeve të hedhura në treg kryhen në bazë të kërkesave të këtij vendimi. Testet dhe provat krahasuese përfshijnë:

- a) farat e prodhuara për tregtim;
- b) farat e përshtatshme për bujqësinë organike;
- c) farat e tregtuara në lidhje me ruajtjen *in-situ* dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve gjenetike bimore.

II.1.4 Paketimi dhe etiketimi i farës së perimeve

1. Paketimi i farave të kategorisë bazë dhe të certifikuara shoqërohet me dy lloj etiketash, që janë etiketa e prodhuesit dhe etiketa zyrtare e lëshuar nga ESHFF-ja.

2. Farat e perimeve të kategorive bazë, e certifikuar dhe standarde, duhet të tregtohen vetëm në lote homogjene dhe të paketuara.

3. Paketat e farave të kategorisë bazë dhe të certifikuara duhet të jenë të etiketuara, në mënyrë të tillë që nuk mund të hapen pa dëmtuar mbylljen dhe/ose etiketën zyrtare.

4. Paketat e vulosura sipas pikës 3 nuk mund të hapen dhe të rimbyllen, përveçse zyrtarisht nën mbikëqyrjen e ESHFF-së. Nëse paketat janë rimbyllur, duhet të shënohet në etiketë rimbyllja dhe data e fundit e rimbylljes.

5. Paketat e farës së kategorisë “standarde” dhe paketat e vogla të farave të kategorisë “e certifikuar” duhet të jenë të mbyllura, në mënyrë të tillë që nuk mund të hapen pa dëmtuar mbylljen dhe/ose etiketën zyrtare.

6. Paketat e vogla me farë të kategorisë “e certifikuar” nuk mund të paketohen ose të rimbyllen, përveçse nën mbikëqyrjen e ESHFF-së.

7. Paketat me farë të kategorisë, bazë dhe të certifikuar, përveç rasteve kur janë në paketa të vogla:

a) do të etiketohen në pjesën e jashtme me etiketën zyrtare që përmbush kushtet e përcaktuara në aneksin IV (A), bashkëlidhur vendimit. Etiketa mund të vendoset në brendësi të paketave transparente, me kusht që ajo të mund të lexohet. Ngjyra e etiketës duhet të jetë e bardhë për farën bazë dhe blu për farën e certifikuar. Në rastet kur fara bazë nuk i plotëson kushtet e përcaktuara në aneksin II, në lidhje me fuqinë mbirëse, ky fakt do të deklarohet në etiketë.

b) do të përmbajnë një dokument zyrtar, në të njëjtën ngjyrë si etiketa, duke dhënë informacionin e kërkuar në aneksin IV (A), pikat 4 deri në 7. Ky dokument do të hartohet në mënyrë të tillë që nuk mund të ngatërrohet me etiketën zyrtare, të përcaktuar në shkronjën “a” të kësaj pike.

8. Paketat me farë të kategorisë “standarde” dhe paketat e vogla me farë të kategorisë “e certifikuar” do të mbajnë edhe etiketën e furnizuesit, sipas përcaktimit në aneksin IV (B),

bashkëlidhur këtij vendimi. Ngjyra e etiketës duhet të jetë blu për farën e certifikuar dhe e verdhë e errët për farën standarde.

9. Përjashtuar rastin e paketave të vogla të farës standarde, informacioni i përshkruar sipas pikës 8 duhet të mbahet në mënyrë të qartë, i ndarë nga çdo informacion tjetër i dhënë në etiketë ose në paketë.

10. Në rastin e paketave të vogla të farës së certifikuar, identiteti i farës mund të vërtetohet, në veçanti, në kohën kur lotet e farës janë të ndara. Për këtë rast, mund të kërkohej që paketat e vogla, të prodhuara brenda vendit, të paketohen zyrtarisht.

11. Trajtimi kimik i farës së kategorisë bazë, të certifikuar dhe standarde, përcaktohet në etiketën zyrtare, në etiketën e furnizuesit, mbi paketë ose brenda saj. Për paketime të vogla, ky informacion mund të shtypet direkt mbi paketë ose brenda saj.

III. CERTIFIKIMI I FARAVE TË PERIMEVE

III.1 Dokumentacioni dhe procedura e certifikimit

1. Procedurat e certifikimit të farave të perimeve realizohen nga autoriteti certifikues ose nga subjekte, publike apo private, sipas përcaktimit në ligjin nr. 10 416, datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”.

2. Kërkesat që duhet të plotësohen për certifikimin e farave të perimeve të prodhuara në vend dhe procedura e certifikimit të tyre janë, si më poshtë vijon:

a) Për certifikimin e farave të perimeve pranë autoritetit certifikues, duhet të paraqiten dokumentet e mëposhtme:

- i) Kërkesa me shkrim për certifikimin e prodhimit të farës së perimeve;
- ii) Licenca përkatëse e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit;
- iii) Aktkontrolli për caktimin e ngastrës së farës, zbatimin e kërkesave agroteknike, teknologjisë së prodhimit të farave sipas metodikave të hartuara për farat e perimeve;
- iv) Certifikata e origjinës që vërteton pastërtinë gjenetike të varietetit;
- v) Certifikata fitosanitare e lëshuar nga shërbimi fitosanitar;
- vi) Aktaprobimi fushor;
- vii) Fletanaliza laboratorike e treguesve cilësorë, për çdo varietet dhe lot që certifikohet, lëshuar nga laborator i miratuar nga ministri;
- viii) Etiketa e prodhuesit;
- ix) Deklarata e konformitetit.

b) Procedura e certifikimit që ndjek autoriteti certifikues është, si më poshtë vijon:

i) Bën verifikimin e dokumentacionit dhe të kontingjentit të farës së perimeve që do të certifikohet, si dhe verifikon nëse varieteti është regjistruar në Katalogun Kombëtar. Pasi konstaton plotësimin e kërkesave për dokumentacionin e mësipërm plotëson procesverbalin për verifikimin e specifikimeve teknike, dokumentacionit, si dhe për kontrollin e cilësisë së farës së perimeve;

ii) Përgatit dosjen e certifikimit për vlerësim në bazë të procesverbalit dhe dokumentacionit të mësipërm;

iii) Në bazë të vlerësimit të dosjes, lëshon certifikatën zyrtare në të cilën shënohen sasia dhe numri i serisë së etiketave zyrtare që i jepen prodhuesit;

c) Etiketa zyrtare vendoset në çdo njësi paketimi sipas numrit të serisë, të përcaktuar në certifikatën zyrtare;

ç) Elementet dhe kriteret e etiketës duhet të jenë sipas aneksit IV, bashkëlidhur këtij vendimi;

d) Certifikata zyrtare lëshohet pasi të jetë likuiduar tarifa e certifikimit dhe pasi të jenë plotësuar dhe tërhequr nga prodhuesi sasi të etiketave zyrtare.

3. Procedura e vlerësimit të dosjes së certifikimit, si dhe lëshimi i certifikatës zyrtare të përfundojnë brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e dorëzimit të kërkesës për certifikim.



4. Nëse subjekti i autorizuar nga ESHFF-ja për kryerjen e procedurave të certifikimit nuk e përfundon këtë procedurë brenda afatit të përcaktuar më lart, atëherë të interesuarit dorëzojnë ankesë pranë ESHFF-së.

5. Nëse ESHFF-ja nuk e përfundon procedurën e certifikimit brenda afatit të përcaktuar më lart, atëherë të interesuarit dorëzojnë ankesë pranë ministrit.

6. Megjithatë, pa rënë ndesh me pikat 2 dhe 3:

a) mund të autorizohen certifikimi zyrtar dhe tregtimi i farës bazë që nuk i përmbush kushtet e përcaktuara në aneksin II lidhur me fuqinë mbirëse. Në këtë rast, furnizuesi garanton një fuqi mbirëse të caktuar, si dhe deklaron të dhëna të tjera për qëllime të tregtimit me një etiketë të veçantë që mban emrin e tij, adresën, si dhe numrin e referencës së lotit të farës;

b) me qëllim që të bëjë farën sa më shpejt të disponueshme, certifikimi do të jepet vetëm me paraqitjen e një raporti të përkohshëm analitik mbi farën dhe me kusht që të jepen emri dhe adresa e marrësit të parë.

7. Fara e perimeve e prodhuar nga fara bazë ose fara e certifikuar, të cilat janë certifikuar zyrtarisht në një shtet anëtar i Bashkimit European për pastërtinë dhe identitetin e farës, do të konsiderohet farë zyrtarisht e certifikuar.

8. Në rastet kur fara është prodhuar direkt nga fara e certifikuar zyrtarisht e breznive para farës bazë, mund të autorizohet edhe certifikimi zyrtar si farë bazë, nëse plotësohen kushtet e përcaktuara për atë kategori.

9. Fara e perimeve e prodhuar në një shtet të Bashkimit European dhe që do të certifikohet në përputhje me pikën 8 duhet:

a) të jetë e paketuar dhe e etiketuar me etiketën zyrtare që plotëson kushtet përcaktuara në aneksin V (A) dhe (B);

b) të shoqërohet nga një dokument zyrtar që plotëson kushtet e përcaktuara në aneksin V (C).

10. Forma, përmbajtja dhe dokumentacioni, që i bashkëlidhet kërkesës për certifikim, është sipas aneksit VI, bashkëlidhur këtij vendimi.

III.2 Marrja e mostrave për vlerësim dhe certifikim

1. Për ekzaminimin e farës për certifikim, mostrat merren zyrtarisht nga specialistët e autoritetit certifikues ose specialistë të tjerë të autorizuar, në përputhje me metodat teknike të përcaktuara me urdhër të ministrit. Këto kërkesa zbatohen edhe në rastin kur mostrat e farës standarde merren për testet e postkontrollit.

2. Kur marrja e mostrave të farës kryhet sipas pikës 1, duhet të përmbushen kërkesat e mëposhtme:

a) Marrësit e mostrave të farës duhet të kenë kualifikimet e nevojshme teknike të marra në kurse trajnimi;

b) Performanca e marrësve të mostrave të farës do të jetë objekt i mbikëqyrjes së duhur nga ana e autoritetit certifikues;

c) Për qëllime të mbikëqyrjes, të referuar në shkronjën “b”, një pjesë e loteve të farës që kanë hyrë për certifikim zyrtar kontrollohen nga autoriteti certifikues. Kjo pjesë duhet të jetë përhapur në mënyrë të barabartë sa të jetë e mundur mbi personat, fizikë dhe juridikë, që fusin farën për certifikim. Kjo pjesë do të jetë të paktën 5%. Kjo marrje e mostrave për kontroll nuk zbatohet për marrjen e mostrave automatike.

3. Për ekzaminimin e farës për certifikim dhe të testeve për postkontroll, mostrat duhet të merren nga lote homogjene, ku pesha maksimale e një loti dhe pesha minimale e një mostre jepet në aneksin III, bashkëlidhur këtij vendimi.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKSI I KUSHTET PËR CERTIFIKIMIN E BIMËVE

1. Bima duhet të ketë identitet dhe pastërti të mjaftueshme varietore.
2. Në rastin e farës bazë, të paktën do të kryhet një kontroll zyrtar në fushë. Në rastin e fares së certifikuar të kryhet, të paktën një kontroll në fushë, ku së paku kontrollohet 20% të bimëve të çdo specie.
3. Gjendja e bimëve në fushë dhe faza e zhvillimit të tyre do të jenë të tilla që të lejojnë identitetin, pastërtinë varietore dhe statusin shëndetësor.
4. Distanca minimale nga parcelat me bimë fqinjë që mund të rezultojnë me pllenim të padëshirueshëm të huaj të jetë:
 - A. Panxhari (*Beta vulgaris*)
 1. Nga çdo burim i polenit të gjinisë Beta që nuk përfshihen më poshtë se 1 000 metra;
 2. Nga burime të polenit të varieteteve të nënspecieve të njëjta që i përkasin një grup të ndryshëm të varieteteve:

a) për farën bazë	1 000 metra;
b) për farën e certifikuar	600 metra;
 3. Nga burime të polenit të varieteteve të nënspecieve të njëjta që i përkasin të njëjtit grup të varieteteve:

a) për farën bazë	600 metra;
b) për farën e certifikuar	300 metra.
 - B. Speciet e Brassica (*Brassica species*)
 1. Nga burime të polenit të huaj të aftë të shkaktojë përkeqësim serioz të varieteteve të specieve Brassica:

a) për farën bazë	1 000 metra;
b) për farën e certifikuar	600 metra;
 2. Nga burime të tjera të polenit të huaj të aftë të kryqëzohet me varietetet e specieve Brassica:

a) për farën bazë	500 metra;
b) për farën e certifikuar	300 metra.
 - C. Çikorja industriale (*Cichorium intybus*)
 1. Nga specie të tjera të së njëjtës gjini ose nënspecie 1 000 metra;
 2. Nga një varietet tjetër i çikores industriale:

a) për farën bazë	600 metra;
b) për farën e certifikuar	300 metra.
 - D. Specie të tjera
 1. Nga burime të polenit të huaj i aftë të shkaktojë përkeqësim serioz të varieteteve të specieve tjera, si rezultat i pjalmimit të kryqëzuar:

a) për farën bazë	500 metra;
b) për farën e certifikuar	300 metra;
 2. Nga burime të tjera të polenit të huaj i aftë të kryqëzojnë me varietete të specieve të tjera si rezultat i pjalmimit të kryqëzuar:

a) për farën bazë	300 metra;
b) për farën e certifikuar	100 metra.



Këto distanca mund të mos merren parasysh, nëse ka një mbrojtje të mjaftueshme nga çdo pllenim i huaj i padëshiruar.

3. Sëmundjet dhe organizmat e dëmshëm të cilat ulin dobinë e farës, do të jetë në nivelin më të ulët të mundshëm.

ANEKSI II KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË FARA

1. Farat duhet të ketë identitet dhe pastërti të mjaftueshme varietore.
2. Sëmundjet apo organizmat e dëmshëm që zvogëlojnë dobishmërinë e farës të jenë në nivelin më të ulët të mundshëm.
3. Farat duhet të plotësojnë edhe kushtet si më poshtë:
 - a) Standardet

Speciet	Pastërtia analitike minimale (% në peshë)	Përmbajtja maksimale e farave të specieve të tjera bimore (% në peshë)	Fuqia mbirëse minimale (në % të farës së përbërë ose farës së thjeshtë)
<i>Allium cepa</i>	97	0,5	70
<i>Allium fistulosum</i>	97	0,5	65
<i>Allium porrum</i>	97	0,5	65
<i>Allium sativum</i>	97	0,5	65
<i>Allium schoenoprasum</i>	97	0,5	65
<i>Anthriscus cerefolium</i>	96	1	70
<i>Apium graveolens</i>	97	1	70
<i>Asparagus officinalis</i>	96	0,5	70
<i>Beta vulgaris</i> (Ch. beet)	97	0,5	50 (farë e përbërë)
<i>Beta vulgaris</i> (të tjera nga Cheltenham beet)	97	0,5	70 (farë e përbërë)
<i>Brassica oleracea</i> (lulelakër)	97	1	70
<i>Brassica oleracea</i> (të tjera nga lulelakra)	97	1	75
<i>Brassica rapa</i> (lakra Kineze)	97	1	75
<i>Brassica rapa</i> (turnip)	97	1	80
<i>Capsicum annuum</i>	97	0,5	65
<i>Cichorium intybus</i> (partim) (Çikoret gjeth),	95	1,5	65
<i>Cichorium intybus</i> (partim) (çikorja industriale)	97	1	80
<i>Cichorium endivia</i>	95	1	65
<i>Citrullus lanatus</i>	98	0,1	75
<i>Cucumis melo</i>	98	0,1	75
<i>Cucumis sativus</i>	98	0,1	80
<i>Cucurbita maxima</i>	98	0,1	80
<i>Cucurbita pepo</i>	98	0,1	75
<i>Cynara cardunculus</i>	96	0,5	65
<i>Daucus carota</i>	95	1	65
<i>Foeniculum vulgare</i>	96	1	70
<i>Lactuca sativa</i>	95	0,5	75

<i>Lycopersicon esculentum</i>	97	0,5	75
<i>Petroselinum crispum</i>	97	1	65
<i>Phaseolus coccineus</i>	98	0,1	80
<i>Phaseolus vulgaris</i>	98	0,1	75
<i>Pisum sativum</i>	98	0,1	80
<i>Raphanus sativus</i>	97	1	70
<i>Rheum rhabarbarum</i>	97	0,5	70
<i>Scorzonera hispanica</i>	95	1	70
<i>Solanum melongena</i>	96	0,5	65
<i>Spinacia oleracea</i>	97	1	75
<i>Valerianella locusta</i>	95	1	65
<i>Vicia faba</i>	98	0,1	80
<i>Zea mays</i>	98	0,1	85

b) Kërkesa shitesë

i) farat e bimëve bishtajoreve nuk duhet të jenë të prekura nga insekte të gjalla, si më poshtë:

Acanthoscelides obtectus Sag.

Bruchus affinis Froel.

Bruchus atomarius L.

Bruchus pisorum L.

Bruchus rufimanus Boh.

ii) farat nuk duhet të jenë të kontaminuara nga *Acarina* e gjallë.

c) Standarde të tjera apo kushte të aplikueshme, kur referenca është bërë për to, tregohen në tabelën sipas shkronjës “a”:

Në rastin e varieteteve të *Zea mays* (misri i ëmbël – superllojet e ëmbla) minimumi i kërkuar i kapacitetit të fuqisë mbirëse është reduktuar në 80% të farës së pastër.

Etiketa zyrtare ose etiketa e furnizuesit, aty ku është e përshtatshme, të përfshijë fjalët “kapaciteti i fuqisë mbirëse 80%”.

ANEKSI III PESHA E LOTIT

1. Pesha maksimale e një loti fare:

a) farat e *Phaseolus coccineus*, *Phaseolus vulgaris*, *Pisum sativum* and *Vicia faba* 30 tonë

b) farat e një madhësie jo më të vogël se një kokërr gruri, përveç *Phaseolus coccineus*, *Phaseolus vulgaris*, *Pisum sativum* dhe *vicia faba* 20 tonë

c) farat e madhësisë ë të vogël se një kokërr gruri 10 tonë

Pesha maksimale e lotit nuk duhet të jetë më shumë se 5% mbi peshën e përcaktuar.

2. Pesha minimale e një mostre

Speciet	Pesha (në g)
<i>Allium cepa</i>	25
<i>Allium fistulosum</i>	15
<i>Allium porrum</i>	20
<i>Allium sativum</i>	20
<i>Allium schoenoprasum</i>	15



<i>Anthriscus cerefolium</i>	20
<i>Apium graveolens</i>	5
<i>Asparagus officinalis</i>	100
<i>Beta vulgaris</i>	100
<i>Brassica oleracea</i>	25
<i>Brassica rapa</i>	20
<i>Capsicum annuum</i>	40
<i>Cichorium intybus</i> (çikoret gjeth)	15
<i>Cichorium intybus</i> (çikorja i industriale)	50
<i>Cichorium endivia</i>	15
<i>Citrullus lanatus</i>	250
<i>Cucumis melo</i>	100
<i>Cucumis sativus</i>	25
<i>Cucurbita maxima</i>	250
<i>Cucurbita pepo</i>	150
<i>Cynara cardunculus</i>	50
<i>Daucus carota</i>	10
<i>Foeniculum vulgare</i>	25
<i>Lactuca sativa</i>	10
<i>Lycopersicon esculentum</i>	20
<i>Petroselinum crispum</i>	10
<i>Phaseolus coccineus</i>	1 000
<i>Phaseolus vulgaris</i>	700
<i>Pisum sativum</i>	500
<i>Raphanus sativus</i>	50
<i>Rheum rhabarbarum</i>	135
<i>Scorzonera hispanica</i>	30
<i>Solanum melongena</i>	20
<i>Spinacia oleracea</i>	75
<i>Valerianella locusta</i>	20
<i>Vicia faba</i>	1 000
<i>Zea mays</i>	1 000

Në rastin e F-1, varieteteve hibride të specieve të mësipërme, pesha minimale e mostrës mund të zvogëlohet me një të katërtën e peshës së specifikuar. Megjithatë, mostra duhet të ketë një peshë të paktën 5 g dhe të përbëhet nga të paktën 400 fara.

ANEKSI IV ETIKETA

A. Etiketa zyrtare (fara bazë dhe fara e certifikuar, përjashtuar paketat e vogla)

I. Informacioni i kërkuar

1. “Rregullat dhe standardet”.
2. Autoriteti certifikues dhe shtetin anëtar ose inicialet e tyre.
3. Muaji dhe viti i vulosjes e shprehur kështu: “vulosur ... (muaji dhe viti)”, ose muaji dhe viti i marrjes të mostrës së fundit për qëllime certifikimi, e shprehur kështu: “mostra ... (muaji dhe viti)”.
4. Numri i referencës së lotit.
5. Speciet e treguara të paktën në shkronja romake, me emrin e tyre botanik, që mund të jepet në formën e shkurtuar dhe pa emrat e autorëve, ose emrin e tij të zakonshëm, ose të dyja.
6. Varieteti, i treguar të paktën me shkronja romake.

7. Kategoria.

8. Vendi i prodhimit.

9. Pesha e deklaruar neto ose bruto ose numri i deklaruar i farave.

10. Kur pesha është treguar dhe janë përdoren pesticidet e granuluara, substancat veshëse ose shtues të tjerë të ngurtë, natyra e aditivit dhe gjithashtu, raporti i përafërt midis peshës së të përbëra apo farave të thjeshta dhe peshës totale.

11. Në rastin e varieteteve të cilat janë hibride ose linja inbrede:

- Për farën bazë, ku linja hibride ose inbrede, së cilës i përket fara, është pranuar zyrtarisht sipas këtij vendimi:

emri i këtij komponenti, nën të cilin ajo ka qenë pranuar zyrtarisht, me ose pa referencë të varietetit final, shoqëruar, në rastin e hibrideve apo linjave inbrede, të cilat janë të destinuara vetëm si komponentë për varietetet finale, nga fjala “komponent”,

- Për farën bazë në raste të tjera:

emri i komponentit të cilët i përket fara bazë, që mund të jepet në formë kodi, i shoqëruar me një referencë të varietetit përfundimtar, me ose pa referencë të funksionit të tij (mashkull ose femër), si dhe shoqëruar nga fjala “komponent”,

- Për farën e certifikuar:

emri i varietetit të cilit i përket fara, i shoqëruar me fjalën “hibrid”.

12. Kur është ritestuar të paktën fuqia mbirëse, mund të shënohen fjalët “ritestuar...”, (muaji dhe viti)”.

I. Përmasat minimale të etiketës:

110 × 67 mm

B. Etiketa e furnizuesit ose mbishkrimi mbi paketat (fara standarde dhe paketa të vogla të kategorisë “farë e certifikuar”)

I. Informacioni i kërkuar

1. “Rregullat dhe standardet”.

2. Emri dhe adresa e personit përgjegjës për ngjitjen e etiketave ose shenjën e tij të identifikimit.

3. Viti i vulosjes për tregtim ose i verifikimit të fundit të fuqisë mbirëse. Mund të shënohet dhe viti i fundit i lejuar për tregtim.

4. Speciet, të treguara të paktën me shkronja romake.

5. Varieteti, i treguar të paktën me shkronja romake.

6. Kategoria: në rastin e pakove të vogla, “fara e certifikuar” mund të shënohet me shkronjën “C” ose “Z” dhe “fara standarde” me shkronjat “ST”.

7. Numri i referencës, dhënë nga personi përgjegjës për ngjitjen e etiketave - në rastin e farës standarde.

8. Numri i referencës, duke mundësuar identifikimin e lotit të certifikuar - në rastin e farës së certifikuar.

9. Peshën e deklaruar neto ose bruto apo deklarimin e numrit të farërave, përveç pakove të vogla deri në 500 gramë.

10. Kur është treguar pesha dhe janë përdorur pesticidet e granuluara, substancat veshëse ose shtues të tjerë të ngurtë, natyra e aditivit dhe gjithashtu raporti i përafërt ndërmjet peshës së farërave të përbëra ose farërave të thjeshta dhe peshës totale.

II. Përmasat minimale të etiketës (përfshijë paketat e vogla)

110 × 67 mm



ANEKSI V ETIKETA DHE DOKUMENTI QË OFROHET NË RASTIN E NJË FARE NË PROCES CERTIFIKIMI

A. Informacioni i kërkuar për etiketën

- Autoriteti përgjegjës për kontrollin fushor (ESHFF);
- Speciet, treguar të paktën në karaktere (shkronja) romake, nën emrin e saj botanik, që mund të jenë dhënë në formë të shkurtuar dhe pa emrat e autorëve, ose nën emrin e saj të përbashkët, ose të dyja;

- Varieteti, i treguar të paktën me shkronja romake;

- Kategoria;

- Fusha ose numri i referencës së lotit;

- Pësia e deklaruar neto ose bruto;

- Fjalët “farë jo përfundimisht e certifikuar”.

B. Ngjyra e etiketës

Etiketa do të jetë me ngjyrë gri.

C. Informacioni i kërkuar për dokumentin

- Autoriteti që lëshon dokumentin (ESHFF);
- Speciet, treguar të paktën në karaktere romake, nën emrin e saj botanik, që mund të jenë dhënë në formë të shkurtuar dhe pa emrat e autorëve, ose nën emrin e saj të përbashkët, ose të dyja;

- Varieteti, i treguar të paktën me shkronja romake;

- Kategoria;

- Numri i referencës së farës të përdorur për t’u mbjellë në fushë dhe emrin e vendit apo vendeve që kanë certifikuar atë farë;

- Loti i fushës ose numri i referencës;

- Sipërfaqja e kultivuar për prodhimin e lotit, shoqëruar nga dokumenti;

- Sasia e farës së vjelë dhe numri i paketave;

- Vërtetimi që janë plotësuar kushtet që duhet të plotësohen nga bimët nga e cila vjen fara;

- Kur është e përshtatshme, rezultatet e një analize paraprake të farës.

ANEKSI I/1 LISTA E PERIMEVE SIPAS SHKRONJËS 2 TË PIKËS 1.1 TË KREUT I

<i>Allium cepa</i> L.	Qepa
- <i>Cepa</i> Group	Grupi i qepëve
- <i>Aggregatum</i> Group	Qepa e njomë
<i>Allium fistulosum</i> L.	Qepa e Welsh-it
<i>Allium porrum</i> L.	Prasi
<i>Allium sativum</i> L.	Hudhra
<i>Allium schoenoprasum</i> L.	Chives
<i>Anthriscus cerefolium</i> (L.) Hoffm.	Chervil
<i>Apium graveolens</i> L.	Selino
<i>Asparagus officinalis</i> L.	Asparagus
<i>Beta vulgaris</i> L.	Panxhari i kuq
<i>Brassica oleracea</i> L.	Lakra kale
	Lulelakra
	Brokoli
	Lakra e Brukselit
	Lakra e Savojës

<i>Brassica rapa</i> L.	Lakra e bardhë
<i>Capsicum annuum</i> L.	Lakra e kuqe
<i>Cichorium endivia</i> L.	Kohlrabi
<i>Cichorium intybus</i> L.	Lakra kineze
<i>Citrullus lanatus</i> (Thunb.) Matsum.et Nakai	Turnip
<i>Cucumis melo</i> L.	Speci
<i>Cucumis sativus</i> L.	Endiviet
<i>Cucurbita maxima</i> Duchesne	Çikoret gjethe
<i>Cucurbita pepo</i> L.	Çikore industriale
<i>Cynara cardunculus</i> L.	Shalqiri
<i>Daucus carota</i> L.	Pjepri
<i>Foeniculum vulgare</i> Mill.	Kastravec
<i>Lactuca sativa</i> L.	Kungulli i dimrit
<i>Lycopersicon esculentum</i> Mill.	Kungulli i njomë
<i>Petroselinum crispum</i> (Mill.) Nyman ex A. W. Hill	Angjinare
<i>Phaseolus coccineus</i> L.	Karota
<i>Phaseolus vulgaris</i> L.	Finoku
<i>Pisum sativum</i> L. (partim)	Sallata
<i>Raphanus sativus</i> L.	Domatja
<i>Rheum rhabarbarum</i> L.	Majdanozi
<i>Scorzonera hispanica</i> L.	Fasulja bishtajëgjatë
<i>Solanum melongena</i> L.	Barbunja
<i>Spinacia oleracea</i> L.	Bizelja
<i>Valerianella locusta</i> (L.) Laterr.	Rrepat
<i>Vicia faba</i> L. (partim)	Rhubarb
<i>Zea mays</i> L. (partim)	Scorzonera
	Patëllxhani
	Spinaqi
	Valeriana
	Batha
	Misri i ëmbël



ANEKSI VI
FORMA DHE PËRMBAJTJA E DOKUMENTACIONIT QË I BASHKËNGJITET KËRKESËS
PËR CERTIFIKIM

Model 1

KËRKESË PËR CERTIFIKIM

Drejtuar: Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve (ESHFF)

Tiranë

Për prodhimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, parashikuar në nenin 15 të ligjit nr. 10 416, datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”.

Të dhëna për furnizuesin:

1. Emri mbiemri:.....
2. Adresa:
3. Emërtimi i subjektit dhe adresa:
4. Nr. NUIS (nga QKL-ja)
5. Nr. personal i
identifikimit:.....

Të dhëna për përfaqësuesin e autorizuar:

1. Emri e mbiemri
2. Adresa:
3. Nr. personal i identifikimit:

Të dhëna mbi materialin mbjellës dhe shumëzues bimor që kërkohet të prodhohet

Nr.	Specia	Varieteti	Kategoria	Sasia	Vendi i prodhimit*	Varieteti i regjistruar në katalogun kombëtar (KK)
1						
2						
3						
4						
5						
6						

Afati kohor i tregtimit:.....

Furnizuesi:

.....
Emri, mbiemr, firma dhe vula

Vendi dhe data:

ENTI SHETËROR I FARAVE DHE FIDANËVE
SEKTORI I CERTIFIKIMIT ZYRTAR

PROCESVERBAL

MBI CAKTIMIN E NGASTRËS SË FARËS

Mbahet sot, më datë, në ekonominë, fshati, komuna....., rrethi....., për caktimin e ngastrës së farës të kulturës, kultivari....., (hibridi)....., që do të mbillet me farë të Riprodhimit, gjatë vitit.....

Kjo ngastër fare caktohet në ekonominë e, me sip.ha, në kushte (mbi ose nën ujë), dhe me distancë izolimi në hapsirë nga kultivarët e tjerë prej m.

Për realizimin e prodhimit të farës prej, furnizuesi merr përsipër të zbatoj këto hallka të teknologjisë:

1.
2.
3.
4.
5.
6.

Procesverbali mbahet në 3 (tri) kopje, njëra prej të cilave i lihet furnizuesit, një kopje mbahet nga DRB përkatëse dhe një kopje dorëzohet në sektorin e certifikimit pranë Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve.

FURNIZUESI SPEC. DRB-së SPEC CERTIFIKIMIT ZYRTAR ESHFF



ENTI SHTETËROR I FARAVE DHE FIDANËVE
SEKTORI I CERTIFIKIMIT ZYRTAR

CERTIFIKATË E ORIGINËS

PËR MATERIALIN MBJELLËS DHE SHUMËZUES BIMOR TË PRODHUAR NË VEND

(Bazuar në ligjin nr. 10 416 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor, datë 7.4.2011, neni 16/c”.)

Në mbështetje të ligjit nr. 10 416 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, datë 7.4.2011, neni 16/c”, nën përgjegjësinë time personale dhe ligjore lëshoj këtë certifikatë origjine, për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor, me të dhënat e mëposhtme:

Specia:
Variateti:
Riprodhimi:
Numri referencës:
Numri i serisë së etiketës zyrtare:
Viti i prodhimit:
Vend origjina:

FURNIZUESI

.....
(firma, vula)

Tiranë, më.....

ENTI SHTETËROR I FARËRAVE DHE FIDANËVE
SEKTORI CERTIFIKIMIT ZYRTAR

AKTKONTROLI
PËR PARCELËN E FARËS

(Bazuar në nenin 16/a të ligjit nr. 10 416, datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”.)

I mbajtur sot, më datë, në parcelat e prodhimit materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, te furnizuesi Z....., qarku: komuna:.....; parcela (vendndodhja):..... mbi zbatimin e teknologjisë për prodhimin e farës specia: kultivari:....., riprodhimi:, të mbjella në një sipërfaqe prej ha.

Nga kontrolli zyrtar rezultoi se janë zbatuar këto kushte teknike të përcaktuara;

.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....

Ky aktkontroll mbahet në 3 (tri) kopje, njëra prej të cilave i lihet furnizuesit, një kopje mbahet nga DRB-së përkatëse dhe një kopje dorëzohet në sektorin e certifikimit zyrtar në ESHFF.

FURNIZUESI SPEC. DRB-së SPEC.CERTIFIKIMIT ZYRTAR (ESHFF)



AKTAPROBIMI PËR NGASTRËN E PRODHIMIT TË FARËS

(Bazuar në ligjin nr. 10 416 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, datë 7.4.2011,
neni 16, pika 1/a)

Sot, më datë prej specialistëve të sektorit të certifikimit zyrtar të ESHFF-së
Z....., u bë aprobimi fushor i ngastrës së farës
(nr. ose emri)....., në ekonominë e furnizuesit Z....., fshati
....., komuna

1. Nga të dhënat cilësore të farës rezulton:

- Ngastra është mbjellë me farë të: specia,, kultivari.....,
- Riprodhimi; sipërfaqjaha ; dokumenti i origjinës.....

2. Mbas verifikimit del se:

- Është siguruar izolimim.
- Është zbatuar teknologjia
- Sipërfaqja e vlefshme për farëha,

Kultivari (hibridi):, riprodhimi:, sasia e farës që parashikohet të merret
.....kv, kategoria:

3. Gjendja e zhvillimit të bimëve në çastin e aprobimit paraqitet :

.....
.....
.....

4. Treguesit e aprobimit fushor:

Pastërtia varietore% (.....)
Pastërtia nga barërat e këqija % (.....)
Prekjet nga sëmundjet virusale % (.....)
Prekjet nga sëmundjet kërpudhore % (.....)

a) (.....)

b) (.....)

5. Dëmtime nga dëmtuesit (.....)

6. Detyrimet e furnizuesit për trajtimin deri në tregtim:

.....
.....
.....
.....

FURNIZUESI

.....

GRUPI I APROBIMIT

() () ()

DEKLARATË KONFORMITETI

Unë i nënshkruari, z me licencë nr., datë kod fiskal nr....., datë, me adresë, sot në datën, deklaroj në përgjegjësinë time personale se materiali mbjellës bimor..... i prodhuar nga ana ime është konform këtij specifikimi teknik:

1. Është i shoqëruar me certifikatën e origjinës nr., datë
2. Është i shoqëruar me certifikatën fitosanitare nr., datë
3. Është i shoqëruar me rezultatin e analizës nr., datë
4. Specia
5. Varieteti
6. Riprodhimi
7. Cilësia
8. Është i ambalazhuar në, me peshë
9. Është i etiketuar me etiketa të lëshuara nga dhe i përket lotit nr.

Lëshoj këtë deklaratë konfirmimiteti komform ligjit nr. 10 416, datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, neni 11 dhe 12, si dhe mbaj përgjegjësi për vërtetësinë e specifikimeve teknike të bëra në këtë deklaratë.

DEKLARUESI

(.....)

datë.....



ENTI SHTETËROR I FARAVE DHE FIDANËVE
SEKTORI I CERTIFIKIMIT ZYRTAR
PROCESVERBAL

Mbi verifikimin e specifikimeve teknike, dokumentacionit, si dhe kontrollin e cilësisë së farës

Në zbatim të ligjit nr. 10 416, datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, midis specialisteve të certifikimit zyrtar z..... dhe furnizuesi..... sot në datën, mbahet ky procesverbal, për verifikimin e treguesve cilësorë dhe dokumentacionin për farën e prodhuar/importuar si vijon:

1. Furnizuesi....., ka prodhuar/importuar farë të species me këta tregues:

- a) Varieteti
- b) Riprodhimi
- c) Viti i prodhimit.....
- d) Kontingjenti
- e) Nr. i lotit
- f) Etiketa me nr. serie.....

Dokumente që disponon:

- a) Certifikatë origjine nr....., datë.....
- b) Certifikatë fitosanitare nr....., datë.....
- c) Fletë analize nr....., datë.....
- d) Aktaprobimi nr....., datë.....
- e) Deklaratë konfirmiteti nr....., datë.....
- f) Procesverbal i kontrollit nr., datë.....,

Nga verifikimit i dokumenteve, si dhe nga rezultatet e analizave laboratorike rezulton se fara është e prodhuar në përputhje me specifikimet teknike, prandaj duhet të pajiset me certifikatë zyrtare, pasi subjekti të ketë shlyer tarifën e certifikimit, në shumën lekë.

FURNIZUESI

SPECIALISTET E CERTIFIKIMIT ZYRTAR

.....

(.....) (.....)

MINISTRIA E BUIQËSISË USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT
ENTI SHETËROR I FARAVE DHE FIDANËVE
LABORATORI QENDROR I TESTIMIT TË FARAVE

Vula e laboratorit

FLETANALIZA E LOTIT TË FARËS

E LËSHUAR PËR APLIKANTIN PA PËRGJEGJËSINË E LABORATORIT				
Emri i aplikantit				
Specia	Kultivari	Kategoria	Pesha e lotit	Nr. i ref së lotit

INFORMACION

Laboratori i testimit	Shtetëror
Mostra e sjellë nga	Zyrtare
Nr. lotit	Natyrë e certifikatës
Vula e lotit	

Nr. i mbajtësve	Data e mostrimit	Data e pranimit	Data e testimit	Numri i testit

REZULTATI I ANALIZËS

Emri shkencor i species

Pastërtia			Nr. ditëve të testit	Mbirja					Lagështia %
% në peshë				në %					
Farë e pastër	Lëndë inerte	Fara të tjera		Filiza normal	Fara të forta	Fara të freskëta	Fara anormale	Fara të vdekura	

Lloji i lëndës inerte.....

Fara të tjera

Përgjegjësi i laboratorit



MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT
ENTI SHTETEROR I FARAVE DHE FIDANAVE
AUTORITETI CERTIFIKUES

CERTIFIKATË ZYRTARE

“ PËR MATERIALIN MBJELLËS DHE SHUMËZUES BIMOR TË PRODHUAR NË VEND “

/ FARA /

NR. _____, DATË, _____.

Në mbështetje të ligjit Nr. 10416, datë 07.04.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, Neni 14, Sektori i Certifikimit Zyrtar, pasi administroi dokumentacionin teknik të përcaktuar në Nenin 15 dhe 16 të këtij Ligji, dhe e vlerësoj atë të rregullt, lëshon këtë Certifikatë Zyrtare për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor, të prodhuar në vend, me të cilën konfirmon se:

Loti i farës i mëposhtem, është prodhuar nga furnizuesi _____, sipas procedurave teknike të përcaktuara, është paisur me etiketën zyrtare të lëshuar nga ESHFF dhe ka të dhënat që vijon;

Specia
Varieteti
Kategoria.....
Kodi furnizuesit.....
Pesha e lotit
Lloji i njësisë së paketimit
Pesha e njësisë së paketimit.....
Numri i Serisë të Etiketës Zyrtare
Numri i Analizës Kontrollit, ESHFF.
Ngjyra e Etiketës Zyrtare

SEKTORI I CERTIFIKIMIT ZYRTAR

PËRGJEGJËSI

Tiranë, më.....

VENDIM
Nr. 40, datë 16.4.2013

**MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 134, DATË 17.9.2012, TË MARRËVESHJES SË
FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE MIDIS SHOQËRISË KESH SHA/FPSH DHE
SHOQËRISË CEZ SHPËRNDARJE SHA/FPP PËR PERIUDHËN 1.1.2012-31.12.2014, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 dhe nenit 26, pika 1, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikës 4.12 dhe 4.13 germa “a”, pika 2, të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008, të ndryshuar, pikës V.1, të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 68, datë 23.6.2008, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 16.4.,2013, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit,

VENDOSI:

1. Pika 8.3.ii e vendimit nr. 134, datë 17.9.2012, ndryshuar me vendimin nr. 160, datë 26.11.2012, mbi marrëveshjen e furnizimit me energji elektrike midis shoqërisë KESH sh.a./FPSH dhe shoqërisë CEZ shpërndarje/FPP, ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Në rastin e importit të një sasi më të vogël se humbjet reale në rrjetin e shpërndarjes, “CEZ shpërndarje” do të kompensojë këtë sasi të energjisë elektrike të siguruar nga KESH sh.a., deri në fund të muajit m+2. Në rast se kompensimi nuk kryhet brenda periudhës m+2, “CEZ shpërndarje” sh.a., është i detyruar të kompensojë KESH sh.a., në muajin m+3, me vlerën monetare që i korrespondon kostove oportune të shkaktuara dhe të identifikuara nga KESH sh.a. për sigurimin e kësaj sasi të energjisë elektrike. Në mungesë të importit të energjisë elektrike nga ana e KESH sh.a. për muajin përkatës dhe KESH sh.a., ka eksport, kompensimi do të bëhet me vlerën monetare që i korrespondon çmimit të eksportit në bandë të muajit “m” të shoqërisë KESH sh.a.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 2484, datë 11.3.2013, vendosi shpalljen të vdekur të shtetases Bakushe Visha.

VENDIM

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, në datën 15.4.2013, vendosi shpalljen të vdekur të shtetasit Bejto Dedja.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 6.5.2013
Doli nga shtypi më 6.5.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 42 lekë